REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 733, 753/20
Datë/Datum. 17.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Ilaz Papaj-Ekspert Shqyrtues	*Data e autorizimit të ekspertit 05.11.2020*	*Data e dorëzimit të raportit 16.11.2020*	Nr. i lëndës: *733-753/20*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 30.09.2020,OE"Security Code"Shpk-Prishtinë dhe datë 02.10.2020,OE "Delta Security"Prishtinë ,kanë parashtruar ankesë me nr: 733-753/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë, OE"Alpha Private Security"Shpk-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit" **Sigurimi fizik për objekte shëndetësore publike (QKMF dhe QMU)**" me nr.prokurimi 616-20-1945-2-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)) –"KK Prishtinë".

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**,lloji i kontratës:Kontratë Publike Kornizë,**Shërbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **850.000.00 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE "SECURITY CODE" SHPK -PRISHTINË

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- **Neni 7 i LPP- së**
- **Neni 28 i LPP-së**
- **Neni 59 i LPP-së**
- **Neni 60 i LPP-së**
- **Neni 31 i LPP-së**

1. **Neni 7(pargf.1 dhe 6) i LPP**

Paragraf .1 thot:.*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Pargraf. 6,ne pjesen(vi) thot:..*që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse*

-Ne si OE konsiderojme qe AK duke shpallur fitues OE ofertues "Alpha Private Security SHPK" me çmimin

1'146'810.17€ ka ra ne kundershtim me ligjin LPP-se dhe kriteret e DT sepse ky ofertues ka ofertuar çmim nen pragun e përcaktuar sipas kritereve të dosjes se tenderit në këtë aktivitet të prokurim, tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit FDT ,Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale,*9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe professional:numer 4,faqe 16 në DT.*

Shih kërkesat e dosjes se tenderit :

4. Analiza finaciare për pagen bazë 250€ bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore simbas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ATK-së.Ofertuesi se bashku me oferte duhet te prezantojë një analizë finaciare për pagën bazë 250 € bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet te paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet te përfshijë se paku-Pagat bazë Bruto 250 € për punëtorë, -Pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore,-Pushimet vjetore,-Trusti pensional,-Fitimi i OE,-TVSH-ja,-Totali i ofertës.

Ne si OE kemi plotësuar të gjitha kërkesat sipas dosjes se tenderit dhe kritereve të përcaktuara në dosjen e tenderit.

-Pastaj edhe pse edhe tek Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME,faqe 19-20 te DT pika 1 qe fillon me shpjegimet dhe detyrimet ndaj punëtoreve dhe të cilat përcaktojn pragun e Çmimit të ofertës shih si në vijim:

Me qëllim të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të punëtorëve, OE është i obliguar që të respektoj të gjitha të drejtat të cilat dalin nga ligji I punës, rregulloret dhe udhëzimeve tjera në fuqi.

Për të qartësuar pagën e punëtorëve, ne ju sqarojmë si më posht:

• Për pika 24 orëshe kemi vetëm 8 orë të ndrrimit të natës.

• Për pika 12 orëshe kemi 8 orë të ndrrimit të natës.

• Për pika 8 orëshe kemi vetëm orë të ditës.

Kurse për të nxjerrur numër të punëtorëve duhet kalkuluar si vijonë sipas udhëzimit të MPMS Nr/09/2017 ku fondi i orëve për një punëtor është 176 orë, dmth numëri total i orëve për secilen pikë /176 jep numër të punëtorëve.

OE janë të obliguar të paraqesin analizë financiare për secilin pozicion dmth 8 orësh,12 orësh dhe 24 orësh, orëve të ndrrimit të natës (8 orë, të cilat duhet të paguhen 30% më shumë se ora e rregullt e punës, nga ora 22 deri në orën 06), orëve të ditëve festive, të gjitha në bazë të ligjit të punës.

Komisioni duke mos perfill apo lexuar fare keto kritere të DT na ka shpallur si tenderues të pasukseshem poashtu duke mos bere një analizë dhe ekzaminim të sakt , Analizen financiare të OE "Alpha Private Security SHPK" ka shpallur si të suksesshëm , e cila nuk është në harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit dhe kërkesave në aneksin 1 Specifikimet teknike të detyrueshme:

1. ***OE i shpallur fitues nga AK ka kalkuluar duke mos i respektuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe duke kalkuluar në mënyr të gabuar-qëllimshme kërkesat për orët në ndërrimet e natës e <u>sidomos për vemendjen e juaj të pikërojet që janë në orarin 12 orëshe,specifikisht qe ruajn vetem natën</u> , ku për pozicionin e kërkuar sipas DT ka qene kërkesa si në vijim dhe e ndarë në tri kategori;***
   1)*Për pika 24 orëshe kemi vetëm 8 orë të ndrrimit të natës.,*2) Për pika 12 orëshe kemi 8 orë të ndrrimit të natës,3) Për pika 8 orëshe kemi vetëm orë të ditës

<u>• Për pika 24 orëshe kemi vetëm 8 orë të ndrrimit të natës.</u>

Sipas kërkesës në tabelen e Çmimeve janë kërkuar 8 pika 24 orëshe , ose në total orë sipas pikerojeve janë kërkuar:

*1 pike roje 24 orëshe * 30.5 dite në muaj =732 ore në muaj * 36 muaj = 26352 ore për 36 muaj * 8 pikëroje = 210816 orë – kërkesa sipas AK për fondin e orëve për mbulimin e pikërojeve 24 orëshe.*
Kërkesat e dosjes se tenderit ka qene si në vijim:
-Pagat bazë Bruto 250 € për punëtorë, -Pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore,-Pushimet vjetore,-Trusti pensional,-Fitimi i OE,-TVSH-ja,-Totali i ofertës.

TABELA I - Për pika 24 orëshe kemi vetëm 8 orë të ndërrimit të natës dhe duhet të angazhohen 32 puntorë .

Nr	Përshkrimi i aktivitetit/obligimeve per punetoret më ndrrime 24h	Shuma/Vlera	Periudha
1	Paga bazë bruto(për orë të dites **250€/176orë=1.42€** ora e punes e dites) Bruto	250.00€	Mujore
2	**59** orët e nates 30% SHTESË(**59 orë x 0.42€** ndryshimi për orë të natës) Bruto	25.14€	Mujore
3	**6** orët e festave 50% SHTESË(**6 orë x0.71€** ndryshimi për orë të natës) Bruto	4.26€	Mujore
4	Pushimi vjetor (kater javë)20 ditë pune(160 orë x 1.42€=227.20€/12 muaj	18.93€	Mujore
5	Totali bruto më pushim vjetor,orë të natës dhe festa (Nr.1+2+3+4=5)	298.33€	Mujore
6	Trusti pensional i punëdhënesit 5%	14.92€	Mujore
7	Totali i Pagëses më trust pensional 10%,tatim në burim,pushim vjetor,orë të nates dhe festa. (Nr. 5+6=7)	313.25€	Mujore
8	Fitimi i kompanis	0.10€	
9	Kostoja totale e pjestuar per fondin e oreve sipas UA MPMS Nr.09/2017 (7+8+9=10)	313.35€	Mujore
10	Tvsh-ja 18%	56.40€	ujore
11	Kostoja totale e pjestuar per fondin e oreve sipas UA MPMS Nr.09/2017 me TVSH(10+11=12)	369.75€	
12	Fondi i oreve është **176** për një muaj sipas UA MPMS Nr.09/2017	176 orë	Mujore
13	Një orë pune për roje(Totali **369.75€** pjëstuar për **176** orë pune) (Nr. 12/13=14)	2.10€	Për një orë
14	26'352 orë shumëzuar për 8 pikeroje që jan 24 orë	210'528 orë	36 muaj
15	**Totali i obligimeve per punetoret më ndrrime 24h**	**442'108.80€**	**36 muaj**

Ne si OE ofertues në ketë aktivitet të prokurimit konsiderojmë se Ç'do ofertues i cili në ofertë ka kalkuluar Çmimin për njësi me pak se 2.10€ është nen pragun e pagës të kërkuar nga autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit .

2. ***OE i shpallur fitues nga AK ka kalkuluar duke mos i respektuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe duke kalkuluar në mënyr të gabuar-qëlimshme kërkesat për orët në ndërrimet e natës , ku për pozicionin e kërkuar sipas DT ka qene kërkesa si në vijim:***

• **Për pika 12 orëshe kemi 8 orë të ndrrimit të natës.**

Kërkesat e dosjes se tenderit ka qene si në vijim:
-Pagat bazë Bruto 250 € për punëtorë, -Pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore,-Pushimet vjetore,-Trusti pensional,-Fitimi i OE,-TVSH-ja,-Totali i ofertës.
Sipas kërkesës në tabelen e Çmimeve janë kërkuar 25 pika 12 orëshe , ose në total orë sipas pikerojeve janë kërkuar:
*1 pike roje 12 orëshe * 30.5 dite në muaj =366 ore në muaj * 36 muaj = 13'176ore për 36 muaj * 25 pikëroje*

= 329'400 orë – kërkesa sipas AK për fondin e orëve për mbulimin e pikërojeve 12 orëshe.
*Kërkesa e DT për 8 orë të ndërrimit të natës dhe 4 orë ndërrimit të ditës për pikat 12 orëshe , sipas kësaj kërkese na del që 4 orë në ditë * 30.50 ditë në muaj = 122 orë në muaj qe duhet kalkuluar si orë ditë për pikë rojet 12 orëshe dhe 8 orë në ditë * 30.50 ditë në muaj =244 orë në muaj qe duhet kalkuluar si ore nate (30% shtese sipas ligjit të punës).*
Për mbulimin e një pikë roje 12 orëshe sipas ligjit të punës kërkohen 2 punëtore , prandaj 122 orë në muaj pjëstuar për 2 punëtorë = 61 orë në ndërrimin e rregullt të dite për një të punësuar , për një muaj ,
Për mbulimin e një pikë roje 12 orëshe sipas ligjit të punës kërkohen 2 punëtore , prandaj 238 orë në muaj pjëstuar për 2 punëtorë =116 orë në ndërrimin e natës (shtese 30%) për një të punësuar për një muaj ,
Për mbulimin e një pikë roje 12 orëshe sipas ligjit të punës kërkohen duhet kalkuluar mesatarja 1ditë punë feste në muaj , prandaj 12 orë në muaj punë në feste pjëstuar për 2 punëtore = 6 orë punë në ndërimin feste për një të punësuar , për një muaj

TABELA II - Për pika 12 orëshe kemi 8 orë të ndrrimit të natës dhe 4 orë te dites.dhe sipas specifikacionit teknik te DT duhet te angazhohen 54 puntorë në orarin 12 orë .

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit/obligimeve për punëtoret 12 orë .Paga 250€ bruto(për orë të dites **250€/176orë=1.42€** ora e punes e dites) Bruto	Shuma/Vlera	Periudha
1	61 Orë të dites shumezuar per 1.42	86.62€	Mujore
2	116 orët e nates 30% SHTESË(59 orë x 1.84€ ndryshimi për orë të natës) Bruto	213.44€	Mujore
3	6 orët e festave 50% SHTESË(6 orë x2.13€ ndryshimi për orë të natës) Bruto	12.78	Mujore
4	Pushimi vjetor (kater javë)20 ditë punë(160 orë x 1.42€=227.20€/12 muaj	18.93€	Mujore
5	Totali bruto më pushim vjetor (Nr.1+2+3+4=5)	331.77€	Mujore
6	Trusti pensional i punëdhënesit 5%	16.59€	Mujore
7	Totali i Pagëses më trust pensional 10%.pushim vjetor. (Nr. 5+6=7)	348.36€	Mujore
8	Fitimi i kompanis	0.10€	Mujore
9	Kostoja totale e pjestuar per fondin e oreve sipas UA MPMS Nr.09/2017 (7+8=9)	348.46	Mujore
10	TVSH-ja 18%	62.72	Mujore
11	Kostoja totale e pjestuar per fondin e oreve sipas UA MPMS Nr.09/2017 me TVSH(9+10=11)	411.18	Mujore
12	Fondi i oreve është **176** për një muaj sipas UA MPMS Nr.09/2017	176 orë	Mujore
13	Një orë pune për roje(Totali **411.18€** pjëstuar për **176** orë pune) (Nr. 11/12=13)	2.34€	Për një orë
14	Një orë pune më TVSH shumëzuar për totalin e orëve	329'400h	**36 Muaj**
15	**Totali për punëtoret 12 orë**	**769'560.75€**	**36 Muaj**

Vërejtje: është e pa kuptim se si OE i shpallur fitues ka ofertuar Çmimin e njejte për një punëtorë në muaj , për pozicionet:

- **Për pika 24 orëshe kemi vetëm 8 orë të ndrrimit të natës dhe 16 orë te dites.**
- **Për pika 12 orëshe kemi 8 orë të ndrrimit të natës dhe vetem 4 orë te dites.**

Kur është e dukshme se kërkesat janë të ndryshme në keto pozicione dhe në pikërojet 12 oreshe dominojn dukshëm orët e natës.

Ne si OE ofertues në ketë aktivitet të prokurimit konsiderojmë se Ç'do ofertues i cili në ofertë ka kalkuluar Çmimin për njësi me pak se 2.34€ është nen pragun e pagës të kërkuar nga autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit

3. ***OE i shpallur fitues nga AK ka kalkuluar duke mos i respektuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe duke kalkuluar në mënyr të gabuar-qëlimshme kërkesat për orët në ndërrimet e natës , ku për pozicionin e***

kërkuar sipas DT ka qene kërkesa si në vijim:

• Për pika 8 orëshe kemi vetëm orë të ditës.

Kërkesat e dosjes se tenderit ka qene si në vijim:

-Pagat bazë Bruto 250 € për punëtorë, -Pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore,-Pushimet vjetore,-Trusti pensional,-Fitimi i OE,-TVSH-ja,-Totali i ofertës.

Sipas kërkesës në tabelen e Çmimeve janë kërkuar 1 pike roje 8 orëshe , ose në total orë sipas pikerojeve janë kërkuar:

1 pike roje 8 orëshe * 30.5 dite në muaj =244 ore në muaj * 36 muaj = 8'784 ore për 36 muaj – kërkesa sipas AK për fondin e orëve për mbulimin e pikërojeve 8 orëshe.

TABELA III – Për pika 8 orëshe kemi vetëm orë të ditës dhe sipas specifikacionit teknik të DT duhet te angazhohet 1 punëtor në orarin 8 ore .

Nr	Përshkrimi i aktivitetit/ Dispanzeri antituberkular 8 Orë te dites	Shuma/Vlera	Periudha
1	Paga bazë bruto(për orë të dites **250€/176orë=1.42€** ora e punes e dites) Bruto	250.00€	Mujore
2	Pushimi vjetor (kater javë)20 ditë pune(160 orë x 1.42€=227.20€/12 muaj	18.93€	Mujore
3	Totali bruto më pushim vjetor, (Nr.1+2=3)	268.93€	Mujore
4	Trusti pensional i punëdhënesit 5%	13.45€	Mujore
5	Totali i Pagëses më trust pensional 10%,tatim në burim,pushim vjetor,orë të nates dhe festa. (Nr. 3+4=5)	282.78€	Mujore
6	Fitimi i kompanis	0.10€	
7	Kostoja totale e pjestuar per fondin e oreve sipas UA MPMS Nr.09/2017 (5+6=7)	282.48€	Mujore
8	Tvsh-ja 18%	50.85€	Mujore
9	Kostoja totale e pjestuar per fondin e oreve sipas UA MPMS Nr.09/2017 me TVSH(7+8=9)	333.33€	
10	Fondi i oreve është **176** për një muaj sipas UA MPMS Nr 09/2017	176 orë	Mujore
11	Një orë pune për roje(Totali **333.33€** pjëstuar për **176** orë pune) (Nr. 9/10=11)	1.89€	Për një orë
12	Dispanzeri antituberkular 8 Orë te dites, 244orë(njc muaj).8784 orë(36 muaj)	8784 orë	36 muaj
13	**Totali obligimeve per Dispanzeri antituberkular 8 Orë te dites**	**16'638.99€**	**36 muaj**

Ne si OE ofertues në ketë aktivitet të prokurimit konsiderojmë se Ç'do ofertues i cili në ofertë ka kalkuluar Çmimin për njësi me pak se 1.89€ është nen pragun e pagës të kërkuar nga autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit.

Kërkesa e DT si ne vijim :

VËREJTJE

"Për të qartësuar pagën e punëtorëve, ne ju sqarojmë si më posht:

- ***Për pika 24 orëshe kemi vetëm 8 orë të ndrrimit të natës.***
- ***Për pika 12 orëshe kemi 8 orë të ndrrimit të natës.***
- ***Për pika 8 orëshe kemi vetëm orë të ditës.***

-Pagat bazë Bruto 250 € për punëtorë, -Pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore,-Pushimet vjetore,-Trusti pensional,-Fitimi i OE,-TVSH-ja,-Totali i ofertës.

TABELA IV - Ku 32 punëtor (ne orarin 24 orë) plus 54 punëtor (ne orarin 12 orë) punëtor dhe 1 punëtor(8 orë te dites) =87 ,është nxjerr mesatarja se sa duhet të jëtë Çmimi mesatar i orës(njesis)sipas kërkeses se DT.

Nr.	Rikapitulim për Çmimin përfundimtar		
1	Çmimi për 36 muaj i ofertës ton për orarin 24 orë më TVSH	442'108.80€	36 Muaj
2	Çmimi për 36 muaj i ofertës ton për rojet që janë 12 orë më TVSH	769'560.75€	36 Muaj
3	Dispanzeri antituberkular 8 Orë te dites,8784 orë(36 muaj)shumëzuar për 1.89€(për një orë punë)	16'638.99€	
4	**PAGESA mujore totale momentale për përvojën e punës të të 11 punëtorëve ekzistues është 275.25 € +49.55 tvsh=324.80€ here 36 muaj**	11'692.62	36 Muaj
5	**Çmimi total pjestuar për oret e përgjithëshme**	**1'240'001.16€**	**36 Muaj**
6	Totali i oreve sipas specifikacionit teknik të orëve të përgjithëshme	548'712h	36 Muaj
7	**Çmimi mesatar për një orë pune**	2.26€	Për 1 orë

Përmbledhja – Çmimi mesatar për njësi orë punë sipas kërkesave të dosjes se tenderit si ne vijim:

Çmimi – Për pika 24 orëshe kemi vetëm 8 orë të ndrrimit të natës. = 442'108.80€ Me TVSH 36 muaj

Çmimi - Për pika 12 orëshe kemi 8 orë të ndrrimit të natës. =769'560.75€ Me TVSH 36 muaj

Çmimi- Për pika 8 orëshe kemi vetëm orë të ditës. = 16'638.62€ Me TVSH 36 muaj

Çmimi-Pagesa mujore për përvojen e 11 të punësuareve 275.25€ në muaj + 49.55 tvsh = 324.80€ ne muaj , e shumëzuar për 36 muaj = 11'692.99€ Me TVSH 36 muaj

Çmimi total i Ofertës = 1'240'001.16€ Me TVSH 36 muaj

Totali i Orëve sipas specifikacionit në DT = 548'712 h

Çmimi total i ofertës = 1'240'001.16€ Me TVSH 36 muaj, pjëstuar me Totali i Orëve sipas specifikacionit në DT = 548'712 h , është = 2.26€ Me TVSH

Çmimi për njësi i ofertës për një orë punë = 2.26€ Me TVSH

Kërkesa e dt Kriteret e Dhënie Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët 1

Ne si OE ofertues në ketë aktivitet të prokurimit konsiderojmë se Ç'do ofertues i cili në ofertë ka kalkuluar Çmimin për njësi me pak se 2.26€ është nen pragun e pagës të kërkuar nga autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit dhe duhet konsideruar si Tenderues i papërgjegjëshëm.

Duke ju referuar Vëndimit të datës 14.09.2020 nga AK Komuna e Prishtinës , AK ka ngarkuar formen e analizes finaciare të mbështetur nga Administrata Tatimore e Kosovës , edhe aty ka rezultuar se Çmimi i përgjegjshëm për mbulimin e kërkesave të jete Çmimi mesatar për njësi 2.26€ kurse nga ana tjeter kanë shpallur fitues OE"Alpha Private Security SHPK" me Çmim mesatar për njësi 2.09 € në kundershtim faktik me vete analizen finaciare të AK !

- Neni 59 i LPP-së, - Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

AK gjatë vlerësimit të tenderit ka vepruar në kundërshtim të ligjin duke na shpallur si tenderues të pasuksesshëm , dhe duke vlërsuar ofertën e OE "Alpha Private Security SHPK" me çmimin 1'146'810.17€ si tenderues të sukseshëm ka vepruar në kundërshtim LPP sepse OE i shpallur fitues nuk ka kalkuluar sipas kërkesavë të dosjes se tenderit.

Ne si OE kemi argumentuar se analiza financiare është në harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, ndersa AK gjatë vlerësimit nuk i është përmbajtur kërkesavë të dosjes se tenderit dhe ka shpallur fitues tenderuesin e papërgjegjshëm.

Është vertet për tu habitur se si AK gjatë vlerësimit të analizës financiare e cila është ofertuar nga OE i shpallur fitues ne ketë aktivitet , komisioni i ka mbyllur sytë me ose pa qellim duke tejkaluar gabimin , ku OE I shpallur fitues ne analizë financiare paraqet shpenzime të njejta për një punëtorë ne dy pozicione ku kërkesat janë diametralisht të kundërta , behet fjale për pozicionet :

Çmimi – Për pika 24 orëshe kemi vetëm 8 orë të ndrrimit të natës dhe ,(ku është 1/3 e orëve ndërrim të dites)

Çmimi - Për pika 12 orëshe kemi 8 orë të ndrrimit të natës(ku është 1/3 e orëve ndërrim të natës)

Prandaj kërkojmë qe nga eksperti shqyrtues të analizohen kërkesat sipas dosjes se tenderit , sepse shihet se komisioni i AK nuk i ka analizuar dhe vlerësuar me kujdes kërkesat e dosjes se tenderit për pagen bazë Bruto 250 € për punëtorë, -Pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore,-Pushimet vjetore,-Trusti pensional,-Fitimi i OE,-TVSH-ja,-Totali i ofertës.Po ashtu kërkojme vemendjen e ekspertit edhe tek konstatimi i AK , se Çmimi për njësi i përgjegjshem në ketë aktivitet , duke ofruar një analizë sipas kërkesave dhe ne harmoni me ligjet ATK-se duhet të jetë Çmimi për njësi 2.26€ , ndersa AK ka dal në kundërshtim me ketë vlerësim sepse ka shpërblyer me kontratë OE ofertues "Alpha Private Security SHPK" me çmimin për njësi 2.09€, AK ka vepruar ne kundershtim me ligjin LPP-se duke vepruar kunderligjshem sepse ky ofertues ka ofertuar çmim nen pragun e përcaktuar sipas kritereve të dosjes se tenderit në ketë aktivitet të prokurimit.

- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

AK duke shpallur fitues në ketë aktivitet "Alpha Private Security SHPK" me çmimin 1'146'810.17€ i cili eshte vertetuar se eshte nen pragun e caktuar nga AK prej per vleren 93'190.99€ ose pragu edhe per njesi eshte 2.26€ e vertetuar edhe nga ATK-ja ka vepruar në kundërshtim LPP me nenin 60 paragrafi 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Sespse oferta OE Security Code me çmimin 1'240'001.16€ është oferta e vetme e përgjegjëshme sipas kriterit me çmimin më të ulët.

Neni 31 Ekzekutimi i kontratave

Paragrafi 2 .- Autoritetet Kontraktuese mund të referohen në kushtet e performancës së kontratës në veçanti atyre të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e punëtorëve dhe kushteve të punës të cilat janë në fuqi me ligj apo rregullore në Kosovë, me kusht që këto kushte të përfshihen në shpalljen e kontratës dhe në specifikimet teknike. Autoriteti kontraktues mund të vendosë, ndër të tjera, kushte specifike në kontratë të cilat lejojnë që objektivat sociale të merren parasysh, në mënyrë alternative si në vijim:AK rrezikon qe nese nënshkruan kontratë me OE te shpallur fituers në ketë aktivitet , gjatë ekzekutimit të kontratës do të shkelet Neni 31 Ekzekutimi i kontratave, sepse OE i shpallur fitues me çmimin e ofertuar nuk mund të mbuloj kërkesat për pagën e kërkuar sipas dosjes se tenderit shih Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME faqe 19 dhe 20 të DT

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE "DELTA SECURITY" SHPK -PRISHTINË

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- **Neni 7 i LPP-së**
- **Neni 59 i LPP-së**
- **Neni 62 i LPP-së**
- **Neni 17 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike (Shpenzimi i Parasë Publike)**

Lidhur me rrethanat faktike mbi bazen e te cilave konsiderojme se AK me rastin shperblimit me kontrate te OE Fitues, ka bere shkelje te dispozitave se Nenit 6, 7, 59, 62 te LPP-se dhe Nenit 17te LMFP-se,gjeni ne vijim argumentet me fakte dhe analiza ligjore:

1. **Pasqyra faktike dhe historiku i procedures**

1.1.Autoriteti kontraktues Komuna e Prishtines *(tutje referuar si AK)*.me date 11.06.2020 ka shpallur njoftimin per kontrate ne lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull:*Sigurimi Fizik per objekte shendetesore publike (QKMF dhe QMU)*.me numer te prokurimit: 616 - *20* -1945 -211 dhe numer te brendshem: 616 - *20 -062* - 211.

1.2.Njoftimi per kontrate eshte bere ne platformen e prokurirnit elektronik *(e prokurimi)*.

1.3.Operatori ekonomik "DELTA Security" Sh.P.K.,permes platformes se prokurimit elektronik ka shkarkuar *(doënload)* dosjen e tenderit me numer dhe titull te specifikuar si me larte *(tutje referuar si DT)*.

1.4.Me date 16.06.2020,AK ne platformen e prokurirnit elektronik ka publikuar Formularin Standard per Korrigjimin e Gabimeve ne njoftimet e publikuara,permes se cileska bere disa permiresime ne lidhje me DT.

1.5.Nje operator ekonomik ofertues ne lidhje me kete aktivitet te prokurimit, ka parashtruar tek AK kerkese per sqarime ne lidhje me kerkesat e parashtruara me dosje te tenderit.konkretisht

ne lidhje me vleren e parashikuar te kontrates dhe mundesise qe ofertat e OE ta kalojne vleren e parashikuar te kontrates duke u bazuar ne kerkesat specifike sa i perket DT.

1.6.AK me date 06.07.2020, ne platformen e prokurimit elektronik ka publikuar njoftimin ne me sqarimet shtese per OE ne lidhje me kete aktivitet te prokurimit dhe kerkeses per sqarim te parashtruar nga OE ofertues, duke dhene kete sqarim si ne vijim: *Autoriteti kontraktues ju njofton se aktiviteti i prokurimit eshte me kontrate korniize pre]* 36 *muajsh.Kjo kontrate mund t e realizohet me perqindje + dhe - 30% te vleres totale te kontrates. Prandaj OE ofertues duhet te kalkulojne pagat me analize financiare sipas Ligjit te Punes Nr.03/L-212.Kjo kontrate mund te permbyllet brenda* 36 *muajsh apo me shume apo me pak varesisht nga vlera e realizuar + dhe - 30%.*

1.7.MalTe parasysh kete pergjigje te dhene nga AK, eshte e kuptueshme qe vlera maksimale e kesaj kontrate mund te arrinte ne vleren prej 1,105,000.00 E, bazuar ne vleren a parashikuar te kontrates e cila ishte ne shumen prej 850,000.00 E.

Prove: *850,000.00 + 30% = 1,105,000.00 €*

1.8.Bazuar ne sqarimet e publikuara nga AK dhe nga interpretimi logjik ne lidhje me vleren maksimale te kontrates,grupi i operatoreve ekonomik "Delta Security" &"Rosa Security" *(tutje OE Ankues* ka ofertuar ne lidhje me kete AP dhe kane ofertuar me nje çmim prej 1,033,870.06 €.

1.9.AK permes njoftimit se dates 14.09.2020.ka shperblyer me kontrate OE "Alpha Private Security" i cili ka ofertuar me nje çmim prej 1,146,810.17 €. ç mim qe ka tejakuluar buxhetin e parashikuar per kete aktivitet te prokurimit per 35%.ndersa OE Ankues e ka eliminuar si te papergjegjshem per kinse mos plotesim te kritereve sipas dosjes se tenderit ne piken 9.1. dhe 9.2. lidhur me analizën financiare per kalkulirn te pages se punetoreve.

1.10.Per shkaqet qe do ti theksojme me poshte kete kerkese per rishqyrtim, OE Ankues konsideron se, AK me rastin e narrjes se ketij vendimit per shperblirn me kontrate dhe vendimit per refuzim te ankeses se OE Ankues ka bere shkelje te:

Nenit 7 te LPP-se *(Barazia ne Trajtim / Jo - diskriminimi).*

Nenit 59 te LPP-se *(Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve)* lidhur me **Nenin 44.5.** pika (ii) te RRUOPP-se,

Nenit 62 te LPP-se *(Perfundimi i Aktivitetit te Prokurimit)* lidhur me **Nenin 44.6.** te RRUOPP-se.

Nenit 17 te Ligjit per Menaxhirnin e Financave Publike *(Shpenzimi i parave publike).*

E te gjitha keto shkelje te dispozitave te theksuara me larte ne menyre direkte jane te nderlidhura dhe paraqesin shkelje te **Nenit 6 te LPP-se** *(Ekonomiciteti dh.e Efikasiteti).*

2. Lidhur me shkeljet e dispozitave të LPP-se

2.1.Autoritet kontraktues, me rastin e shperblimit me kontrate te OE Fitues,ka bere shkelje te dispozitave te LPP-se, per shkak se AK ne njoftim in per kontrate dhe dosje te tenderit ka parashikuar qe vlera e kontrates ne lidhje me kete aktivitet të prokurimit te jete ne shumen prej 850,000.00 €, me nje tolerance prej plus ose minus (+ / -) 30% te kesaj vlere sipas njoftimit te bere vete AK ne pergjigjen ne kerkese per sqarime edhe pse nje e gje e tille nuk eshte dashur te ndodhe per faktin se AK qysh ne fillim te nje aktiviteti te prokurimit duhet te siguroje buxhet te mjaftueshem per ate aktivitet te prokurimit.

2.2.AK me rastin e shperblimit me kontrate te OE fitues, ka vepruar ne kundershtim me dispozitat e LPP-se,per shkak se OE fitues eshte dashur te shpallet papergjegjshern sepse oferta e tij nuk ka qene ne perputhshmeri me te gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin per kontrate dhe dosjen te tenderit.

2.3.OE fitues ka ofertuar me nje cmim qe ka tejkaluar vleren e parashikuar te kontrates ne vleren prej 850,000.00 e te specifikuar ne njoftimin per kontrate dhe dosje te tenderit,e po ashtu ka tejkaluar edhe parashikimet e bera nga AK ne lidhje me mundesine e rritjes se kostos se ketij aktiviteti te prokurimit ne vleren prej plus ose minus (+ / -) 30%.

2.4.OE fitues ka ofertuar me nje cmim prej 1,146,810.17, e qe ne rastin konkret eshte e kuptueshme se kjo oferte tejkalon parashikimet buxhetore te AK ne secilen rrethane, andaj si i tille OE fitues eshte dashur te shpallet si **i** papergjegjshem ne kuptim te Nenit 59 par.3 te LPP-se lidhur me Nenin 44.5. pika (ii) te RRUOPP-se.

2.5.Neni **59 par.4 i LPP-se** thote:*Autoriteti kontraktues do le konsideroje nje tender si te pergjegjshem vetem nese tenderi ne fjale eshte ne perputhshmeri me te gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit.*

2.6.Neni **44.5.** pika **(ii)** 1 RRUOPP-se thote:*Procedura e prokurimit pas hapjes se ofertave duhet te anulohet nese asnjeri prej tendereve te pranuar nuk eshte i pergjegjshetn.*

2.7.Andaj nga interpretimi i ketyre dispozitave ligjore eshte e kuptueshrne se ne rastin konkret,jo vetern OE Fitues, por te gjithe OE ofertues kane qene te papergjegjshem ne kuptim te tejkalimit te vleres se parashikuar te kesaj kontrate, per shkak se ofertat e tyre kane qene ne mes te 1,146,810.17 € - 1,240,001.16 €, ndersa vlera e parashikuar e kontrates ka qene ne shumen prej 850,000.00 €.

2.8.Andaj AK me rastin e shperblimit me kontrate OE fitues.ka bere shkelje te **Nenit** 7 te LPP-

se,per shkak se OE fitues dhe OE ankues nuk e ka trajtuar ne menyre te barabarte, por OE ankues e ka trajtuar ne menyre diskriminuese, per faktin se,OE Ankues eshte eliminuar per kinse mos plotesim te kritereve te dosjes se tenderit nga pika 9.1. dhe 9.2. ndersa OE Fitues eshte shperblyer me kontrate edhe pse i njejti nuk ka qene i pergjegjshem ne kuptim te Nenit 59 par.4 te LPP-se lidhur me Nenin 44.5. pika (ii) te RRUOPP-se sepse oferta e tij ka ka tejkaluar vleren e parashikuar te kontrates per 35%, e qe ne kete rast eshte dashur qe te shpallet si i papergjegjshem.

2.9.AK ne rastin konkret ka ve ne lajthitje te gjithe OE,perfshire ketu OE ankues, per shkak se ne njeren ane ka publikuar njoftimin per kontrate dhe ka perpiluar dosjen e tenderit ne te cilat dokumente eshte parashikuar qe vlera e kontrates te jete ne shumen prej 850,000.00 €,ndersa ne anen tjeter permes sqarimeve ka deklaruar kjo kontrate mund te tejkaloje vleren e parashikuar maksimalisht me plus (+) 30%, ndersa ka shperblyer me kontrate OE fitues i cili ka tejkaluar vleren e parashikuar te kontrates me +35%. Me keto veprime AK ka rene ne kundershtim me veteveten dhe nuk ka asnje dileme ne lidhje me këtë!?.

2.10.Ne rastin konkret,AK ka vepruar edhe ne kundershtim me Nenin 17 te Ligjit per Menaxhimin e Financave Publike,per shkak se me kete dispozite ligjore nuk eshte e lejuar qe nje autoritet publik te devijoje perdorimin e parase publike,ndersa me keto veprime eshte e kuptueshme se AK deshiron qe te beje nje gje te tille dhe te veproje ne kundershtim me Nenin 17 te LMFP-se.

2.11.Neni 17 i LMFP-se *(Shpenzimi i paravе publike)* thote:*Parate publike do te perdoren vetem per qellime te miratuara publike Asnje autoritet publik,organizate buxhetore,person apo ndermarrje nuk mund te devijojne,keq zbatojne,ekspozojne apo te perdorin ne menyre te pa rregullt parate publike.*

2.12.Andaj nga interpretimi i kesaj dispozite ligjore te theksuar me larte,pa asnje medyshje kuptohet se AK nuk i lejohet qe te devijoje nga buxheti i parashikuar per kete aktivitet te prokurimit.

2.13.Po ashtu edhe ne baze te Nenit 62 par.2 te LPP-se lidhur me Nenin 44.6.te RRUOPP-se, autoriteti kontraktues eshte dashur qe ta perfundoje kete aktivitet te prokurimit,per faktin se te gjithe operatoret ekonomik kane ofertuar me emime qe tejkalojne buxhetin e autoritetit kontraktues të parashikuar per kete aktivitet te prokurimit,sepse te gjithe OE kane ofertuar me emime shume here me te larta se vlera e parashikuar prej 850,000.00 €.

2.14.Te gjitha shkeljet e dispozitave ligjore te LPP-së, RRUOPP-se dhe LMFP-se, e te arsyetuara me larte, kane ndikuar ne menyre te drejtperdrejte qe AK pa asnje medyshje te shkel

edhe Nenin 6 te LPP-se, sepse AK me rastin e shperblimit me kontrate te OE Fitues, nuk do te permbushe qellimin e parapare me kete aktivitet te prokurimit ashtu sic eshte parapare me dispoziten e Nenit 6 te LPP-se.

2.15.Me shperblimin me kontrate te OE Fitues,i cili ka ofertuar me nje cmim qe tejkalon per me shume se 35% buxhetin e parashikuar te AK dhe i cili OE eshte dashur te shpallet i papergjegjshem ne kuptim te dispozitave te theksuara me larte, AK me nje veprim te tille do t'i derntoje fondet dhe burimet publike,sepse ne nje rast te tille te njejtat nuk do te perdoren ne menyre me ekonomike,ashtu sic percaktohet me Nenin 6 te LPP-se,andaj edhe mbi bazen e ketyre rrethanave ankesa e OE Ankues duhet te aprovohet nga ana e OSHP-se.

2.16. Ne rastin konkret,do te ishte me e drejte per AK dhe te gjithe OE ofertues,qe ky aktivitet i prokurimit te anulohej ne teresi dhe te ritenderohej,sepse me kete gjendje ekzistuese nuk mund te behet ekzaminimi, krahasimi dhe vleresimi i drejte i tendereve dhe rrjedhimisht OE nuk mund te trajtohen ne menyre te barabarte dhe jo diskriminuese.

3. PERFUNDIM

3.1.Duke marre parasysh te gjitha keto fakte te argumentuara me larte ne kete kerkese per shqyrtim, konsiderojme AK me rastin e shperblimit me kontrate te OE fitues ka vepruar ne kundershtim Nenit 7 par.1 , 2.59 par 4.lidhur me Nenin 44.5.pika (ii) te RRUOPP se, Nenit 62 par.2 te LPP-se lidhur me Nenin 44.6. te RRUOPP-se, Nenit 17 te LMFP se dhe Nenit 6 te LPP-se per shkak se:

- *AK ka bere trajtimin diskriminues dhe te pabarabarte te operatoreve ekonomik;*
- *AK ka shperblyer me kontrate nje OE te papergjegjshem,sepse oferta e tij nuk ka qene ne perputhshmeri me kerkesat e percaktuar ne njoftimin per kontrate dhe dosjen e tenderit;*
- *te gjitha ofertat e OE ofertues tejkalojne buxhetin e parashikuar te autoritetit kontraktues ne lidhje me kete aktivitet te prokurimit ne shumen prej 850,000.00 €;*
- *Fondet publike te parashikuar qe te perdoren ne kete aktivitet te prokurimit nuk do te perdoren ne menyre ekonomike.*

3.2 .Mbi bazen e ketyre fakteve, i propozojme Organit Shqyrtues te Prokurimit qe **APROVOJË** ne teresi si te bazuar ankesen e OE Ankues dhe ta **ANULOJË** kete aktivitet te prokurimit,duke e detyruar AK qe ne te ardhmen te eliminoje paqartesite e paraqitura ne kuptim te vleres se parashikuar te kontrates ne menyre qe te gjithe OE ofertues te mund te trajtohen ne menyre te barabarte dhe jo diskrimuese dhe qe fondet publike te shpenzohen ne menyre ekonomike, konform dispozitave te LPP-se, RRUOPP-se dhe LMFP-se.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe profesional:

***Kërkesa 4** -Analiza finaciare për pagen bazë 250€ bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore simbas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ATK-së.*

***Dëshmia 4**-Ofertuesi se bashku me oferte duhet te prezantojë një analizë finaciare për pagën bazë 250 € bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet te paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet te përfshijë se paku -Pagat bazë Bruto 250 € për punëtorë, -Pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore,-Pushimet vjetore,-Trusti pensional,-Fitimi i OE,-TVSH-ja,-Totali i ofertës*

Vlera e parashikuar e kontratës

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e rivlerësimit, komisioni rivlerësues ka konstatuar si në vijim:

*Komisioni i vlerësimit nga tetë (6) oferta të pranuara,pesë (5) oferta i ka shpallur të përgjegjshme,duke rekomanduar për kontratë ofertën e OE"Alpha Private Security"Shpk-Prishtinë si ofertë me çmim më të ulët nga ofertat e përgjegjshme me çmim prej **1,146,810.17 €***

*Sa i përket ofertës së OE ankues"Security Code "Shpk,komisioni e ka shpallur si ofertë të pasuksesshme e cila ka ofruar çmim më të lartë sesa oferta fituese **(1,240,001.16 €).***

Ndërsa sa i përket ofertës së OE tjetër ankues "Delta Security"Shpk,nga komisioni i vlerësimit kjo ofertë është shpallur e papërgjegjshme (edhe pse si ofertë më e lirë,1,033,870.06 €) me arsyetimin se nuk ka plotësuar kritetrin e dosjes së tenderit në pikën 9.1&9.2 lidhur me analizën financiare për kalkulimin e pagave për punëtorët.Oferta e dorëzuar nga OE ankues nuk është në rregull në analizën e kalkulimit zyrtar nga Administrata Tatimore e Kosovës –ATK e cila ka të bëjë me shumën e pushimit vjetor.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "SECURITY CODE" SHPK

Përgjigjie në pretendimin

Lidhur me pretendimin e OE "Security Code"Shpk,se AK gjatë fazës së vlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE "Alpha Private Security"Shpk edhe pse analiza financiare e prezentuar nga ky OE nuk mbulon pragun e vlerës për pagat e punëtorëve dhe kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit lidhur me detyrimet që dalin nga Ligji i Punës dhe si e tillë kjo ofertë duhej të shpallej e papërgjegjshme,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të dorëzojnë një analizë finaciare për pagen bazë 250€ bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ATK-së,ku ofertuesi se bashku me ofertën duhet të prezantojë një analizë finaciare për pagën bazë 250 € bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212.OE duhet te paraqesë analizë financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet të përfshijë se paku - Pagat bazë Bruto 250 € për punëtorë,pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore,pushimet vjetore,-trusti pensional,-fitimi i OE,-TVSH-ja.-Totali i ofertës.

Gjithashtu në dosje të tenderit është specifikuar sqarimi lidhur me kalkulimet e pagave sipas pikave të sigurimit:

- Për pika 24 orëshe kemi vetëm 8 orë të ndrrimit të natës.
- Për pika 12 orëshe kemi 8 orë të ndrrimit të natës.
- Për pika 8 orëshe kemi vetëm orë të ditës.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë "Alpha Private Security"Shpk për pikën 24 orëshe dhe për pikën 12 orëshe ka kalkuluar çmim të njejtë të pagës për orë (2.07 € për orë) edhe pse numri i orëve të ndrrimit të natës që paguhen +30% më shumë bazuar në Ligjin e punës për pikën 24 orëshe dhe pikën 12 orëshe është i ndryshëm dhe është në raport të kundërt.

Lidhir me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë "Alpha Private Security"Shpk tek analiza financiare për pikën 12 orëshe ka bërë kalkulim të gabuar tek pozicioni i orëve të ndrrimit të natës,eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është i qëndrueshëm dhe më poshtë po paraqes një analizë të thjeshtë lidhur me këtë pozicion të pikës 12 orëshe.

OE i rekomanduar për kontratë në analizën e tij financiare për pikën 12 orëshe ka kalkuluar një çmim të shpenzimeve për orë prej 2.07 € që në total për pikën 12 orëshe ka kalkuluar vlerën prej **681,403.08 €**

Sipas ekspertit shqyrtues për pikën 12 orëshe në tabelën e çmimit të AK-së janë paraparë gjithsej 329,400 orë,që bazuar në sqarimet e AK-së, 8 orë janë të ndrrimit të natës dhe 4 orë të ndrrimit të ditës, që i bie që totali i orëve për ndrrimin e natës është 219,600 orë ndërsa për ndrrimin e ditës totali i orëve është 109,800 orë.

Nëse kalkulojmë vetëm çmimin e orëve të ndrrimit të ditës dhe natës pa përfshirë këtu shpenzimet e orëve të festave,pushimeve vjetore apo edhe fitimit të kompanisë vijmë deri te kjo analizë e thjeshtë:

Orët e ditës 109,800 x 1.42 (250/176)	= 155,916.00 €
Orët e natës 219,600 x 1.84 (1.42*30%)	= 404,064.00 €
Totali i shpenzimeve për orët (329,400)	**= 559,980.00 €**
Kontributi pensional i punëdhensit 5%	= 27,999.00 €
Totali me kontribut pensional	**= 587,979.00 €**
TVSH 18%	=105,836.22 €
Totali me TVSH	**=693,815.22 €**

Eksperti shqyrtues sqaron se vlera totale e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë (681,403.08 €) nuk e mbulon pragun e shpenzimeve për pagat e punëtorëve dhe obligimeve tjera që dalin nga Ligji i punës dhe kërkesat tjera të parashtruar në dosje të tenderit.

AK në vendimin e tij të datës 14.09.2020 ka prezentuar një analizë financiare sipas formulës zyrtare të Administratës Tatimore të Kosovës ku në këtë analizë çmimi për një orë me tvsh është 2.26 € . Konsideroj që AK gjatë vlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka vepruar edhe në kundërshtim me analizën e vet financiare duke rekomanduar për kontratë një OE i cili në ofertën e tij ka kalkuluar çmimin prej 2.09 € për orë,që është shumë më e ulët sesa çmimi i prezentuar në analizën e AK-së (2.26 € për orë).

Eksperti shqyrtues konstaton se AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderëve konform kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit lidhur me analizën financiare dhe obligimeve që dalin nga Ligji i Punës,andaj rekomandon që lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe gjatë ri-vlerësimit të respektohen kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me analizën financiare dhe obligimeve që dalin nga Ligji i Punës.

Pretendimi ankimor është i bazuar

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "DELTA SECURITY" SHPK

Përgjigjie në pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE "Delta Security"Shpk.se AK gjatë fazës së vlerësimit.ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE "Alpha Private Security"Shpk edhe pse kjo

ofertë tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës dhe sipas OE ankues edhe ofertat tjera e tejkalojnë vlerën e parashikuar të kontratës dhe ky aktivitet i prokurimit konform nenit 62 të LPP-së duhet të anulohej,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit dhe Njoftimin për kontratë vlera e parashikuar e kontratës për këtë aktivitet të prokurimit është përcaktuar në shumë prej 850,000.00 €.

AK përmes sqarimeve shtesë ndaj pyetjes së një OE me datë 06.07.2020 sqaron se:
"Autoriteti Kontraktues ju njofton se aktiviteti i prokurimit është aktivitet me kontratë kornizë prej 36 muajsh. Kjo kontratë mund të realizohet me përqindje + dhe – 30 % të vlerës totale të kontratës. Prandaj OE ofertues duhet të kalkulojnë pagat me analizë financiare sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212. Kjo kontratë mund të përmbyllet brenda 36 muajsh apo më shumë apo më pak varësisht nga vlera e realizuar për + dhe – 30%"

Eksperti shqyrtues sqaron se përshkak se kemi të bëjme me kontratë kornizë me afat prej 36 muajsh,është në kompetence dhe përgjegjësi të AK-së,që bazuar në projekcionet/parashikimet buxhetore për tri vitet e ardhshme të vlerësoj se a mund të përfshihet në planifikimet buxhetore shuma e nevojshme për implementimin e kontratës edhe në rastet kur ofertat e tejkalojnë vlerën e parashikuar të kontratës.
Gjithesesi AK në letrën sqaruese ka specifikuar që kjo kontratë mund të përmbyllet brenda 36 muajsh apo më shumë apo më pak varësisht nga vlera e realizuar për + dhe – 30%" dhe sipas ekspertit shqyrtues pretendimi i OE ankues për anulim të aktivitetit të prokurimit është i paqëndrueshëm.

OE ankues "Delta Security"Shpk është dashur që analizën financiare ta kalkuloj konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe jo të bazohet në vlerën e parashikuar të kontratës.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 17 të Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike për devijim apo keq zbatim të parasë publike ,eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse nuk kemi të bëjmë fare me devijim apo keq zbatim të parasë publike.
Fondet e planifikuara për këtë aktivitet të prokurimit do të përdoren për sigurim të objekteve të Komunës së Prishtinës dhe nuk ka devijim apo keq zbatim të parase publike,andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të **aprovohensi pjesërisht si të bazuara**,të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim.**

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – "KK PRISHTINË"
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues - "SECURITY CODE"SHPK
- OE ankues - "DELTA SECURITY"SHPK